



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIK KAMBERI | FAQE 4

# PASIVIZIMI I ADRESAVE TË SHQIPTARËVE NË SERBI NDIKOI NË REZULTATIN ZGJEDHOR



Politikani shqiptar në Luginë të Preshevës, Shaip Kamberi, ka përsëritur kërkesën e tij për përsëritjen e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Kamberi në një intervistë për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se në bazë të rezultateve të tanishme, Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës nuk ka arritur të fitojë asnjë ulëse në parlamentin e Serbisë. Ai ka thënë se ka mbetur pa numëruar edhe një për qind e votave në nivel të Serbisë dhe për të marrë një ulëse të deputetit iu duhen edhe 300 vota. Kamberi ka thënë se procesi i pasivizimit të adresave që selektivisht po zbatohet ndaj shqiptarëve ka ndikuar që komuniteti shqiptar të mos marrë asnjë ulëse në parlament

## AKTUALE



UKRAINA THOTË SE DO TË HAPEN 11 KORRIDORE HUMANITARE F.2

BLERIM ISUFAJ PROPOZOHET PËR EMËRIM NË POZITËN E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT F.3

HAKI ABAZI: LV-ja NUK KA ARDHUR NË PUSHTET PËR TA PËRSËRITUR PDK-NË DHE LDK-në F.7

## EKONOMI



MINISTRI PEÇI VIZITON PRODHUESIT E KOSOVËS NË PANAIRIN "FRUIT LOGISTICA" NË BERLIN F.8

HARADINAJ FTON PROKURORINË TA HETOJË FRYRJEN E FATURAVE TË ENERGJISË F.8

## SPORT



ADEMI EDHE NJË MANDAT NË KRYE TË FFK-së F.10

Me ligjin e ri, të burgosurit do t'i kenë 14 ditë pushim vjetor | FAQE 3



## KRYEDIPLOMATËT E PESË VENDEVE TË BE-SË: TË PËRSHPEJTOHET PROCESI I LIBERALIZIMIT TË VIZAVE PËR KOSOVËN

| FAQE 5

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Curëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNIAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 870 | 045 500 870  
044 500 870 | 049 500 870

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Më 7 prill votohet për pezullimin e Rusesë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut



**NJU JORK, 6 PRILL-** Më 7 prill votohet lidhur me largimin e Rusesë nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara do të votojë më 7 prill për ta suspenduar Rusinë nga trupa e Këshillit për të Drejtat e Njeriut. Ky votim vjen pas raportimeve se trupat ruse kanë kryer krime të rënda në qytetin Buça të Ukrainës. Votimi është

konfirmuar për orën 10:00 të enjten, tha Paulina Kubiak, një zëdhënëse e presidentit të Asamblesë së Përgjithshme, Abdulla Shahid. Dy të tretat e vendeve që votuan në asamblenë prej 193 anëtarësh duhet ta mbështetin pezullimin që Rusia të hiqet përkohësisht nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut me bazë në Gjenevë. Vitet e fundit organizata ka

qenë nën presionin e imponuar nga autoritetet në vazhden e goditjes së vazhdueshme ndaj organizatave joqeveritare, medieve të pavarura dhe institucioneve demokratike në të gjithë Rusinë. Shumë aktivistë, gazetarë dhe njerëz të tjerë janë larguar nga Rusia për në vende të tjera që kur Rusia nisi sulmin në shkallë të gjerë ndaj Ukrainës më 24 shkurt.

## Ukraina thotë se do të hapen 11 korridore humanitare

**KIEV, 6 PRILL** - Zëvendës-kryeministrja ukrainase Iryna Vereshchuk ka thënë se do të hapen 11 korridore humanitare për t'i evakuuar civilët nga zonat e luftës, përfshirë edhe nga qyteti i rrethuar i Mariupolit. Përmes një deklarate në "Telegram", ajo tha se banorët që largohen nga Mariupoli mund ta bëjnë këtë vetëm përmes

makina të tyre private. Vëzhguesit ndërkombëtarë i kanë përshkruar si "apokaliptike" kushtet në këtë qytet-port që gjendet në jug të Ukrainës. Sipas Vereshchuk, konvojet me autobusë do të përdoren për evakuimin e civilëve nga zonat e tjera. Zyrtarët ukrainas gati çdo ditë

tentojnë të hapin rrugë për evakuimin e civilëve nga Mariupoli. Në këtë qytet kanë mbetur të bllokuar mijëra civilë, teksa bombardimet dhe luftimet e ashpra po vazhdojnë. Shumica e tentimeve për evakuim, megjithatë, kanë dështuar, dhe Ukraina dhe Rusia kanë fajësuar njëra-tjetrën për mosrespektim të armëpushimit.



## Kryeministri i Hungarisë i kërkoi Putinit armëpushim në Ukrainë



**BUDAPEST, 6 PRILL** - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orbán, ka thënë të mërkurën se ka zhvilluar një bisedë të gjatë me presidentin rus Vladimir Putin. Në një konferencë për medie Orbán ka theksuar se i ka kërkuar Putinit, i cili e ka

pushtuar Ukrainën nga 24 shkurti, të bëjë një armëpushim të menjëhershëm. Orbani ka deklaruar se e ka ftuar Putinin që të mbajnë bisedime të paqes në Hungari që, sipas tij, do të mbaheshin së

bashku me presidentin e Ukrainës, Francës dhe kancelarin gjerman. Ai ka thënë se përgjigjja e Putinit ishte "pozitive", por tha se ai pritet që të ketë kushte për këtë. Hungaria ka dënuar pushtimin rus të Ukrainës dhe u është

bashkuar sanksioneve të Bashkimit Evropian. Por, kryeministri Orbán ka thënë se nuk do të lejojë që territori i Hungarisë të përdoret që shtetet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian të dërgojnë armatime në Ukrainë.

## Koalicioni qeverisës në Izrael humbet shumicën

**JERUSALEM, 6 PRILL** - Një anëtare kyçe e partisë Yamina të kryeministrit të Izraelit, Naftali Bennett, ka thënë të mërkurën se do të largohet nga koalicioni qeverisës. Kjo është një lëvizje e papritur që e lë Bennettin pa shumicë parlamentare. Njoftimi i Idit Silman bën që koalicioni i kryeministrit Bennett, i përbërë nga tetë parti, duke filluar nga islamistët, nacionalistët e linjës së ashpër dhe liberalët,

të ketë 60 ulëse në parlament aq sa ka edhe opozita. "Kam tentuar ta ndjek rrugën e unitetit. Kam punuar shumë për këtë koalicion", ka deklaruar Silman, një konservatore fetare, që ka shërbyer si kryetare e koalicionit. "Fatkeqësisht, nuk mund të marr pjesë në dëmtimin e identitetit hebre të Izraelit", shtoi ajo përmes një deklarate. Të hënën, më 4 prill, Silman

kishte kritikuar ministrin e Shëndetësisë, Nitzan Horowitz, pasi ai kishte udhëzuar spitalet që të lejonin produkte të bukës pa tharm brenda objekteve të tyre gjatë festës së Pashkëve, në përputhje me një vendim të Gjykatës Supreme, që lejoi një gjë të tillë, pasi për shumë vite kishte qenë e ndaluar. Sipas traditës hebreje, një produkt i tillë nuk lejohet në domenin publik gjatë Pashkëve. Ende nuk ka një

koment nga Bennett, teksa partia e tij Yamina tani ka vetëm pesë ulëse në Parlamentin prej 120 vendesh. Parlamenti izraelit, apo siç njihet me emrin Knesset, aktualisht është në pushim, dhe ende është e paqartë nëse opozita do të ketë mbështetje të mjaftueshme për të ngritur një mocion mosbesimi ndaj qeverisë, duke bërë që shteti t'i mbajë zgjedhjet e pesta brenda tre vjetësh.



## Turqia rihap ambasadën në Kiev

**ANKARA, 6 PRILL** - Turqia e ka rikthyer ambasadën në Kiev të Ukrainës pasi muajin e kaluar evakuo i stafin për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Përparimi i trupave ruse drejt Kievit bëri që Turqia muajin e kaluar ta zhvendoste

ambasadën e saj në Çernivtsi, qytet në afërsi të kufirit me Rumaninë. "U desh që përkohësisht t'i zhvendosnim aktivitetet tona në qytetin Çernivtsi, që u bë qendra jonë logjistike. Prej sot ne do të kthehemi në Kiev, në shtëpinë

tonë", ka njoftuar Ambasada e Turqisë në Ukrainë përmes një postimi në "Twitter". Ukraina ka thënë se forcat ruse po tërhiqen nga pjesët veriore përreth kryeqytetit ukrainas, Kiev, dhe nga Çernihivi.



# Osmani kërkon që Izraeli t'i heqë përfundimisht vizat për shtetasit e Kosovës

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, të mërkurën ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadorja e parë e shtetit të Izraelit në Republikën e Kosovës, Tamar Ziv.

Osmani ka rikujtuar raportet miqësore me popullin izraelit edhe përpara vendosjes së marrëdhënieve diplomatike. "Populli i Kosovës ka hapur dyert dhe zemrat për popullin hebre në ditët më të vështira, e sot qëndrojmë të gatshëm ta thellojmë bashkëpunimin në të gjitha fushat, përfshirë ekonominë, sigurinë, inteligjencën, shëndetin dhe arsimin.

Bashkëpunimi ndërshtetëror do të thellohet tutje", ka thënë presidentja Osmani.

Memorializimin e viktimave të Holokaustit, Osmani e ka cilësuar si

një mësim të cilin mund ta marrë Kosova nga Izraeli për t'i kujtuar viktimat e luftës dhe për ta shqyrtuar mundësinë e mbështetjes dhe bashkëpunimit në këtë drejtim. Këtë iniciativë presidentja e kishte filluar në bashkëpunim me kryetarin e Kuvendit të Izraelit (Knesset) gjatë periudhës si kryetare e Kuvendit të Kosovës.

Ndërkaq ambasadorja Ziv e falënderoi presidenten Osmani dhe popullin e Kosovës për mbështetjen ndaj popullit hebre në ditët më të errëta e deri më sot, si dhe për përkushtimin për forcimin e marrëdhënieve ndërshtetërore, duke shprehur gatishmërinë për thellim të raporteve në të gjitha fushat.

Ambasadorja përmendi hapat e ndërmarra deri më tani, duke përfshirë thellimin e bashkëpunimit në energjetikë, kulturë, turizëm,



rritjen e këmbimeve tregtare, shtimin e bashkëpunimit ndërparlamentar dhe memorializimin e luftës. Presidentja Osmani kërko

mbështetjen e Izraelit edhe në fushën diplomatike, gjegjësisht në fitimin e njohjeve të reja dhe anëtarësimin në organizata dhe iniciativa ndërkombëtare. Në këtë

drejtim, presidentja kërko që Izraeli t'i heqë përfundimisht vizat për shtetasit e Kosovës, gjë që do ta mundësonte rritjen e turizmit nga të dyja vendet.

## Me ligjin e ri, të burgosurit do t'i kenë 14 ditë pushim vjetor

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 PRILL - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka mbajtur mbledhjen e radhës të hënën. Në këtë mbledhje komisioni, pas shqyrtimit, e ka miratuar në parim Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare; Projektligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale; Projektligjin për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Projektligjin për Shërbimin Sprovues të Kosovës. Paraprakisht, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka paraqitur dhe arsyetuar Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe



Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet civile dhe tregtare. Ajo ka thënë se qëllimi i kësaj marrëveshje është forcimi i bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike, në çështjet civile dhe tregtare, si dhe lehtësimi i procedurës ligjore. Ministrja Haxhiu ka thënë se kjo marrëveshje do të zbatohet për

çështjet që përfshinë procedurat lidhur me gjendjen civile, çështjet familjare, marrëdhëniet e punës, çështjet e pronësisë, si dhe marrëdhëniet e tjera civile dhe tregtare të personave fizikë dhe juridikë.

Po ashtu, ministrja Haxhiu e ka paraqitur dhe arsyetuar edhe Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Ajo, ndër të tjera, ka thënë se, bazuar në

aneksat e shumta të të burgosurve, me këtë projektligj është paraparë që vendimet e panelit për lirim me kusht të ankimohen, më pas të shqyrtohen nga një trup gjykues prej tre gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj Haxhiu ka theksuar se të burgosurit do t'i kenë 14 ditë pushim vjetor, pra shtatë më shumë, plus shtatë të tjera në raste të jashtëzakonshme.

Në vazhdim, Haxhiu, gjatë prezantimit edhe arsyetimit të Projektligjit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka thënë se për herë të parë ky shërbim do të përfshihet me një ligj të veçantë, si një agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. "Do të krijohen dy njësi të veçanta në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim dhe Njësia e Inteligjencës", ka theksuar ajo. Haxhiu, po ashtu, ka bërë me

dije se është paraparë edhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për pjesëtarët e shërbimit korrektues, gradimi, kompensimi për rrezikshmëri në punë, shujta ditore, si dhe pagat jubilare.

Gjatë prezantimit dhe arsyetimit të Projektligjit për Shërbimin Sprovues të Kosovës, ministrja Haxhiu ka thënë se edhe ky institucion për herë të parë do të trajtohet me ligj të veçantë, me qëllim të avancimit të shërbimeve profesionale ndaj personave të dënuar, por që janë nën mbikëqyrje, si dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve funksionale dhe operative për t'i mbikëqyrrur rastet brenda fushëveprimtarisë së tyre.

Anëtarët e këtij komisioni kanë formuar grupin punues për Projektligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, si dhe për Projektligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

## Blerim Isufaj propozohet për emërim në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit

PRISHTINË, 6 PRILL (ER)- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Jetish Maloku, ka mbajtur takimin e 212 me radhë. Paraprakisht, një ndër pikat kryesore të rendit të ditës ishte shqyrtimi i raportit të Komisionit për Rishqyrtim për Procesin e Emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, të cilin anëtarët e KPK-së nuk e miratuan me rekomandimet e aprovuara pjesërisht nga ky komision. Rrjedhimisht, me

mosmiratimin e të gjeturave të Komisionit për Rishqyrtim, KPK-ja, në zbatim të Rregullores nr. 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, kaloi në procesin e votimit të kandidatit më të vlerësuar për ta propozuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit me ç'rast, pas votimit të fshehtë, rezultoi që Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, mori në

mënyrë unanime 11 vota të anëtarëve të KPK-së.

Ky vendim i Këshillit Prokurorial për propozimin e Isufajt në këtë pozitë do t'i dërgohet për dekretim presidentes së Kosovës dhe pas dekretimit do ta marrë zyrtarisht detyrën e tij. KPK-ja vlerësoi, gjatë takimit të sotëm, se tërë procesi për emërimin e Kryeprokurorit të ri të Shtetit ka qenë objektiv, transparent, gjithëpërfshirës dhe i bazuar plotësisht në meritokraci.





FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAIK KAMBERI

## Pasivizimi i adresave të shqiptarëve në Serbi ndikoi në rezultatin zgjedhor

Politikani shqiptar në Luginë të Preshevës, Shaip Kamberi, ka përsëritur kërkesën e tij për përsëritjen e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Kamberi në një intervistë për gazetën "Epoka e re" ka bërë me dije se në bazë të rezultateve të tanishme, Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës nuk ka arritur të fitojë asnjë ulëse në parlamentin e Serbisë. Ai ka thënë se ka mbetur pa numëruar edhe një për qind e votave në nivel të Serbisë dhe për të marrë një ulëse të deputetit iu duhen edhe 300 vota. Kamberi ka thënë se procesi i pasivizimit të adresave që selektivisht po zbatohet ndaj shqiptarëve ka ndikuar që komuniteti shqiptar të mos marrë asnjë ulëse në parlament

**"Epoka e re":** A keni bërë ankesa edhe te faktori ndërkombëtar për këto probleme?

**Shaip Kamberi:** Për të gjitha këto probleme, sidomos për pasivizimin, bashkësia ndërkombëtare është e njoftuar me kohë, por që nuk ka ndërmarrë asgjë lidhur me këtë temë.

parasysh se pasivizimi i vendbanimeve të shqiptarëve që rezultoi me shlyerjen e tyre nga listat zgjedhore nuk ka qenë rastësi?

**Shaip Kamberi:** Kam shtruar këtë kërkesë, i vetëdijshëm se Serbia nuk do ta respektojë nëse nuk ka një ndërhyrje ndërkombëtare. Cili do të jetë reagimi i bashkësisë ndërkombëtare do të shihet, por veç në këtë moment kemi disa ambasada që procesin zgjedhor në Serbi e kanë cilësuar "të rregullt".

**"Epoka e re":** Nëse ndodh që komuniteti shqiptar të mos përfaqësohet në Parlamentin e Serbisë, sa do të jetë vështirë të realizohen kërkesat që mund ketë popullata shqiptare, kur kemi parasysh se në mandatin e kaluar keni qenë zë i fortë i shqiptarëve të Luginës?

**Shaip Kamberi:** Edhe me pjesëmarrjen e tre deputetëve sa kemi qenë në parlament nuk ka qenë aspak e vështirë për t'u përballur me një shtet sikurse Serbia. Tash besoj do të jetë edhe më vështirë sepse Serbia do ta përdorë këtë argument, të mosarritjes së një mandati, për ta arsyetuar qëndrimin e vet se nuk ka shqiptarë në Luginë të Preshevës "sa thonë shqiptarët".

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 6 PRILL** - Politikani shqiptar në Luginë të Preshevës, Shaip Kamberi, ka përsëritur kërkesën e tij për përsëritjen e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës, që përbëhet nga Partia për Veprim Demokratik, bashkë me Partinë Demokratike dhe Lëvizjen e Progresit Demokratik, në zgjedhjet e 3 prillit të Serbisë mori 9 644 vota - të pamjaftueshme për një ulëse në parlament.

Kamberi, në një intervistë për gazetën "Epoka e re", ka thënë se ka mbetur pa numëruar edhe 1 për qind e votave në nivel të Serbisë dhe për të marrë një ulëse të deputetit iu duhen edhe 300 vota. "Ka mbetur vetëm edhe 1 për qind e votave të panumëruara

në nivel të Serbisë për ta kaluar pragun. Për një ulëse në parlament na nevojiten afërsisht edhe 300 vota. Prandaj votat e marra në këtë moment nuk janë të mjaftueshme për një mandat", ka thënë Kamberi, i cili në mandatin e kaluar ishte deputet në Parlamentin e Serbisë.

Ai ka treguar edhe arsyen pse komuniteti shqiptar në Serbi (Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc) nuk arriti të marrë asnjë ulëse në zgjedhjet parlamentare të 3 prillit. "Procesi i pasivizimit të adresave që selektivisht po zbatohet ndaj shqiptarëve po i jep rezultatet e veta, migrim i cili vjen si pasojë e diskriminimit të vazhdueshëm e që ka sjellë largimin e një numri të madh të njerëzve, sidomos të rinjtë janë dy faktorët kyç që ndikuan në numrin më të vogël të të dalëve në këto zgjedhje. Kësaj duhet shtuar edhe numrin e madh të zgjedhësve në nivel të Serbisë, që

me automatizëm e rritë numrin e domosdoshëm për 'pragun natyror' që ndikon për një mandat deputeti", ka bërë me dije Kamberi.

**"Epoka e re":** Z. Kamberi, zgjedhjet e 3 prillit në Serbi u karakterizuan me pjesëmarrje të ulët të votuesve shqiptarë. Pse ndodhi kjo?

**Shaip Kamberi:** Procesi i pasivizimit të adresave që selektivisht po zbatohet ndaj shqiptarëve po i jep rezultatet e veta, migrim i cili vjen si pasojë e diskriminimit të vazhdueshëm e që ka sjellë largimin e një numri të madh të njerëzve, sidomos të rinjtë janë dy faktorët kyç që ndikuan në numrin më të vogël të të dalëve në këto zgjedhje. Kësaj duhet shtuar edhe numrin e madh të zgjedhësve në nivel të Serbisë, që me automatizëm e rritë numrin e domosdoshëm për "pragun natyror" që ndikon për një mandat deputeti.

**"Epoka e re":** "Koalicioni i Shqiptarëve të Luginës", i përbërë nga Partia për Veprim Demokratik bashkë me Partinë Demokratike dhe Lëvizjen e Progresit Demokratik, mori 9 644 vota. A janë të mjaftueshme këto vota që ju të bëheni sërish deputet?

**Shaip Kamberi:** Ka mbetur vetëm edhe një për qind e votave të panumëruara në nivel të Serbisë për ta kaluar pragun. Për një ulëse në parlament na nevojiten afërsisht edhe 300 vota. Prandaj votat e marra në këtë moment nuk janë të mjaftueshme për një mandat.

**"Epoka e re":** Ju kërkonte përsëritjen e zgjedhjeve në Luginën e Preshevës, duke zgjidhur paraprakisht çështjen e mohimit të së drejtës për të votuar çdo qytetar i Luginës së Preshevës. Sa janë gjasat që kjo kërkesë e juaja të realizohet kur kemi

# Kryediplomatët e pesë vendeve të BE-së: Të përshpejtohet procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën

PRISHTINË, 6 PRILL - Ministri i Jashtëm i Austrisë, i Sllovenisë, i Sllovakisë, i Hungarisë dhe i Çekisë i kanë kërkuar shefit të diplomacisë së Bashkimit Evropian, që në mënyrë urgjente të fusë në rend dite Ballkanin Perëndimor në takimin e radhës të Këshillit të Çështjeve të Jashtme, duke e cilësuar këtë rajon me rëndësi të veçantë.

Në një letër dërguar shefit të diplomacisë së BE-së, Josep Borrell, këto shtete thanë se, duke pasur parasysh luftën në Ukrainë dhe ndikimin që mund të ketë në vendet e BE-së, duhet që Këshilli i Çështjeve të Jashtme gjatë prillit të diskutojë për strategjinë në Ballkanin Perëndimor.

Ministrat thanë se "përderisa vetëm disa javë kanë kaluar nga

diskutimi ynë i fundit për Ballkanin Perëndimor, situata gjeopolitike ka përjetuar një ndryshim të madh për shkak të agresionit të pprovokuar dhe të pajustificuar të Rusisë ndaj Ukrainës". "Në këtë kontekst, Ballkani Perëndimor ka një rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh pozitën kyçe strategjike si rajon i rrethuar nga vendet anëtare të BE-së", thuhet në letër.

Kryediplomatët e pesë shteteve të BE-së e vlerësuan vizitën që Borrelli bëri në mars në Shkup, Tiranë dhe Sarajevë, vizitë që, sipas tyre, dëshmoi përkushtimin e fuqishëm të bllokut evropian për Ballkanin Perëndimor. "BE-ja duhet të bëjë gjithçka që t'i parandalojë efektet dëmtuese të sulmit ndaj Ukrainës në Ballkanin

Perëndimor. Për këtë është edhe më urgjente se kurrë më parë që t'i japim një shtytje procesit të integritetit të rajonit në BE", thuhet në letër.

Konkretisht, ministrat kërkuar që të përshpejtohet procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën, nisja e negociatave për anëtarësim me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, dhënia e statusit të vendit kandidat Bosnjë Hercegovinës dhe përshpejtimi i procesit të negociatave me Malin e Zi dhe Serbinë. "Duhet të kemi një pikëpamje të re ndaj çështjeve si nisja e shpejtë e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, gjetja e rrugës për përshpejtimin e negociatave, që janë në vazhdim e sipër, të anëtarësimit me Malin e

Zi dhe Serbinë, ta avancojmë liberalizimin e vizave për Kosovën dhe ta mbështetim konsolidimin e unitetit të Bosnjë Hercegovinës që ta marrë statusin kandidat", kanë shkruar pesë ministrat e Jashtëm të BE-së.

Në letër, po ashtu, u kërkua që të rritet bashkëpunimi praktik me shtetet e Ballkanit si dhe këtyre shteteve t'u jepet ndihmë me qëllim që të përballen me pasojat ekonomike që ka shkaktuar agresioni rus, në veçanti rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe prodhimeve të tjera.

Letrën dërguar Borrellit - i cili kryeson Këshillin e Çështjeve të Jashtme - e kanë nënshkruar ministri i Jashtëm i Austrisë, Alexander Schallenberg, ai i Çekisë, Jan Lipavsky, kryediplotati

hungarez Peter Szijjarto, ministri i Jashtëm sllovak Ivan Korcok dhe ai slloven, Anze Logar.

Takimi i radhës i ministrave të Jashtëm të BE-së do të mbahet më 11 prill në Luksemburg. Ende nuk është e qartë nëse tema e Ballkanit Perëndimor do të vendoset në rend dite pasi, sipas burimeve diplomatike, situata aktuale në Ukrainë dhe krimet e pretenduara të forcave ruse kërkojnë që fokusi i ministrave të jetë për agresionin e Rusisë kundër Ukrainës. Por, gjithnjë e më shumë shtetet e BE-së dhe deputetët e Parlamentit Evropian po kërkojnë që Ballkani Perëndimor të jetë në fokus për shkak të rrezikut të ndikimit të Rusisë në rajon dhe mundësisë që të ketë përshkallëzim të tensioneve.



## Mbi 500 raste aktive me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit, pas 810 testeve, 29 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19 dhe nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes. Të mërkurën janë shënuar 36 qytetarë,

ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 953. Në total numri i rasteve aktive me Covid është 538. Në 24 orët e fundit janë dhënë 194 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë

dhënë 1 823 118 doza të vaksinës.

Deri më sot 820 842 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 100 387 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



## Apeli i Speciales ia refuzon Thaçit kërkesën për lirim nga paraburgimi

HAGË, 6 PRILL - Ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i është refuzuar kërkesa për lirim nga paraburgimi. Paneli i Apelit i Gjykatës Speciale ia ka refuzuar Thaçit ankesën në lidhje me refuzimin e gjyqtarit paraprak për lirim nga

paraburgimi. “Si rezultat, trupi gjykues konstaton se gjyqtari i procedurës paraprake nuk ka gabuar në konstatimin se periudha që Thaçi ka kaluar në paraburgim mbetet e arsyeshme dhe në përputhje

me rrethanat e hedh poshtë pikën G të ankesës së Thaçit”, është thënë në arsyetimin e Panelit. Me këtë rast, palëve u është dhënë kohë që deri në dhjetë ditë pas këtij vendimi të dërgojnë parashtrës në lidhje me refuzimin e Apelit.



## LDK-ja dorëzon kallëzim penal për punësimet në KEK

PRISHTINË, 6 PRILL (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës ka ngritur kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë në lidhje me punësimet e fundit që janë bërë në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK).

Shkëmb Manaj, koordinator i Departamentit për Rend dhe Ligj në LDK, ka thënë se partia në pushtet ka kapur institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike. “Ky kallëzim penal është një thirrje në lidhje me keqpërdorimet që janë bërë në konkursin e fundit të KEK-ut. Ky kallëzim penal është një thirrje për drejtësi për të gjithë

kandidatët të cilëve u janë shkelur të drejtat e tyre nga marrëdhënia e punës”, ka thënë Manaj.

Debati për dyshime për punësimet partiake dhe familjare nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, ka nisur të hënën, më 5 prill, pas punësimit të 128 kandidatëve në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Kjo Korporatë më herët kishte shpallur konkurs për 150 vende të punës, në të cilin kishin aplikuar 4 668 kandidatët. KEK-u, më 5 prill, nëpërmjet një komunikate për medie, ka njoftuar se janë përzgjedhur kandidatët për 128

pozita, ndërsa 17 pozita nuk janë plotësuar. Por, mediet lokale në Kosovë kanë njoftuar se në këtë konkurs janë punësuar familjarë të anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Pas kësaj edhe Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 5 prill, ka konfirmuar se ka nisur hetimet në lidhje me punësimet e reja në këtë korporatë.

Sipas Prokurorisë, do të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim të sqarimit të plotë të këtyre pretendimeve konform dispozitave ligjore në fuqi.



## Policia arreston dy të dyshuar për prerje ilegale të pyjeve në Novobërdë

NOVOBËRDË, 6 PRILL (ER) - Më 5 prill rreth orës 20:00 patrulla policore e Stacionit Policor Novobërdë ka pranuar informatë se disa persona janë duke bërë prerje ilegale të pyjeve në pronën shoqërore në afërsi të fshatit Manishincë të Novobërdës. Patrulla policore me urgjencë ka dalë në vendin e ngjarjes por, për shkak të terrenit të papërshtatshëm, ka kërkuar mbështetje edhe nga Njësi Rajonal për Reagim të Shpejtë. “Njësitë policore kanë arritur që të arrestojnë dy persona të dyshuar B. O. (2002) dhe A. O. (2003) me banim në fshatin Llabjan - Novobërdë, të cilët me automjetet e ngarkuara të cilët ishin duke bartur dru, të cilat dyshohet se i kishin prerë në pronën shoqërore. Masa drusore është konfiskuar nga ana e autoritetit pyjor, ndërsa dy automjetet që besohet se janë përdorur për transport janë konfiskuar nga ana e policisë.



Është njoftuar prokurori i shtetit dhe rasti vazhdon të hetohet në

procedurë të rregullt”, ka njoftuar Policia e Kosovës.

## Arrestohet në Gjilan një person i kërkuar nga Interpoli

GJILAN, 6 PRILL (ER) - Sektori i Hetimeve Rajonale Gjilan, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjilan, ka kryer të mërkurën një operacion policor, në të cilin ka arrestuar personin me inicialet A. A (1973), shtetas i Republikës së Maqedonisë Veriore, në bazë të një fletarrestimi ndërkombëtar të

lëshuar nga Interpoli. Pas arrestimit, atij i është kontrolluar vendqëndrimi i përkohshëm në qytetin e Gjilanit. Me vendim të prokurorit të shtetit nga Prokuroria Themelore Gjilan, ai është ndaluar për 48 orë. Rasti do të trajtohet në bashkëpunim me institucionet përkatëse.



## Aliu: Kontrata Kolektive, problem për komunitat

PRISHTINË, 6 PRILL - Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK), njëherësh kryetar i komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka thënë se këtë detyrë do të përploqet ta kryejë me përgjegjësi të lartë dhe do të punojë për sa më shumë unitet në AKK. Për mandatin që ka filluar, si kryetar i Asociacionit të

Komunave të Kosovës, Aliu ka thënë se ka para vetes një agjendë. “Viti 2022 do të jetë më i rënduar për komunitat si rezultat i kontratës kolektive. Ne duhet të diskutojmë me qeverinë për këtë kontratë, e cila padrejtësisht i bartë detyrimet te komunitat e Kosovës dhe kjo do të jetë problem për

komunitat”, ka thënë ai. Aliu ka folur edhe për problemin e mosfunksionimit të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSH-P). Sipas tij, ky mosfunksionim po u nxjerrë problem shumë komunave për fillimin e implementimit të kontratave për kryerjen e punimeve.

## Haki Abazi: LV-ja nuk ka ardhur në pushtet për ta përsëritur PDK-në dhe LDK-në

PRISHTINË, 6 PRILL - Punësimi i mbi 100 personave në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), që supozohet se janë të afërt me partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje, ka ngjallur reagime në opinionin publik. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë në Kuvendin e Kosovës, Haki Abazi, ka komentuar punësimet e fundit në disa institucione të vendit, në veçanti në KEK, ku pati reagime të ndryshme, duke i cilësuar ato si punësime të parregullta nga partitë opozitare. Deputeti Abazi ka thënë se duhet ta presim punën e sistemit gjyqësor që ka filluar hetimet për punësimet në KEK. "Me sa shoh Prokuroria Themelore ka filluar

hetimet dhe presim punën e saj. Mund të ketë edhe votues të LV-së dhe ata kanë të drejtë të punësohen. Më herët ka ndodhur një diferencim 20-vjeçar të cilët nuk janë pajtuar me menaxhimin të ndërmarrjeve publike", ka thënë ai në një intervistë për RTK. Abazi ka thënë se ai që ka bërë shkelje të ligjit në punësimet në KEK duhet të përgjigjet para organeve të rendit. "Nuk ka ardhur LV-ja në pushtet për ta përsëritur PDK-në e LDK-në. Vetëm një gjyqësi dhe prokurori e pavarur duhet ta kryejnë procesin deri në fund", ka thënë Abazi. Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje ka folur edhe për sfidat e qeverisë Kurti II dhe për ndalimin e mbajtjeve të zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës.



## Kosova dhe Izraeli bashkëpunojnë në fushën e shëndetësisë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 PRILL - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, është takuar të mërkurën me ambasadorën e parë të Izraelit në Kosovë, Tammy Ziv, me ç'rast

temë diskutimi ishte bashkëpunimi mes dy vendeve në fushën e shëndetësisë. Ministri Latifi ka thënë se është i nderuar për vizitën e ambasadores, e para e këtij niveli në Kosovë, posaçërisht duke pasur parasysh se Izraeli

ka një sistem shëndetësor tejet të zhvilluar prej të cilit mund të mësohet shumë. Me këtë rast, ministri Latifi ka përmendur shtatë shtyllat e programit të tij për transformimin e shëndetësisë së Kosovës, duke potencuar se shëndetësia është

prioritet për Qeverinë e Kosovës. Ai e vuri në pah edhe nevojën për krijimin e Qendrave të Ekselencës dhe në këtë pikë edhe Qendrën e Traumës e cila është shumë e domosdoshme për sistemin shëndetësor të

Kosovës. Bashkëpunimi në këtë pikë, vlerësoi ai, është shumë i dobishëm pasi që Izraeli këtë qendër e ka më të avancuarën në botë.

Në vazhdim ministri Latifi dhe ambasadorja Ziv u pajtuan se një nga fushat e tjera potenciale të bashkëpunimit është rreth digjitalizimit të sistemit shëndetësor të Kosovës. Në këtë takim u bisedua edhe për mundësinë e trajnimit të stafit shëndetësor të Kosovës nga ekspertët shëndetësorë të Izraelit, në ato profile ku mungon ekspertiza brenda sistemit tonë.

Ndërsa ambasadorja e Izraelit në Kosovë, Tammy Ziv, ka theksuar se shteti i saj është i gatshëm të bashkëpunojë dhe ta ndihmojë Kosovën në mënyra të ndryshme për përmirësimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe për avancimin e fushave specifike, dhe për këtë qëllim ajo ka njoftuar se tashmë ka filluar përgatitjet për organizimin e vizitës së ministrit Latifi në Izrael gjatë këtij viti.

## PSD-ja dorëzon kallëzim penal ndaj Kurtit, e quan veteran të rrejshëm

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 PRILL - Partia Socialdemokrate (PSD) ka dorëzuar të mërkurën në Prokurorinë Themelore të Prishtinës kallëzim penal ndaj kryeministrit Albin Kurti. Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka thënë para medieve se kallëzimi penal ka të bëjë me deklarimin e rrejshëm të Kurtit lidhur me çështjen e veteranëve. "Sot, së bashku me Dren Kukajn, dorëzuar në Prokurorinë

Themelore kallëzimin penal për deklarimin e rrejshëm të Kurtit si veteran i UÇK-së. Kurti ka dhënë dorëheqje nga UÇK-ja më 2 mars të vitit 1999. Në ndërkohë ligji përkatës definon veteranin si individ i cili ka qenë pjesë e UÇK-së dhe luftës deri në përfundim: qershori 1999. Qartazi mund të shihet mashtrimi. Kurti është deklaruar rrejshëm në kundërshtim me ligjin", ka thënë Molliqaj. Ai ka thënë se pastrimi i listave të veteranëve ka edhe një problem tjetër. "Pa një proces të definuar

për mënyrën sesi do të pastrohen listat e veteranëve, çfarëdo deklarimi në lidhje me çështjen është politike, më shumë se praktikë, më tepër përpjekje për tjetërsim të historisë së UÇK-së, duke e rishpjeguar atë sesa zgjidhje e përhershme e këtij problemi, apo tentim i singertë për afirmim të vlerave. Por, për hir të argumentit, po besojmë që listat me të vërtetë do të pastrohen. Pa asnjë dyshim, ky proces duhet të nisë me veteranin më të madh të rrejshëm në vend: Albin Kurtin", ka thënë Molliqaj.



## AUV: Disa lloje të produkteve 'Kinder' tërhiqen nga tregu i Kosovës

**PRISHTINË, 6 PRILL (ER)** - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës ka njoftuar se, pas lajmërimeve për tërheqje nga tregu të produkteve "Kinder" të rezultuara pozitive në salmonelë në vende të tjera, si masë paraprake është vendosur tërheqja e këtyre produkteve. AUV

ka theksuar se nisur nga hulumtimet mbi mundësitë e shitjes së këtij produkti edhe në Kosovë, "nga dita e parë e lajmërimeve për tërheqje nga tregu të disa serive të produkteve 'Kinder', prodhues 'Ferrero', kanë rezultuar pozitive me salmonelë në vende të tjera. Menjëherë kemi

nisur hulumtimet mbi mundësitë e shitjes së këtij produkti edhe në vendin tonë. Edhe pse deri më tani asnjë nga produktet 'Kinder' të tregtuara në Kosovë nuk ka ndonjë analizë që ka rezultuar pozitive me salmonelë. Ne kemi mandatin për mbrojtjen e konsumatorëve i cili është

prioriteti ynë. Ne koordinim dhe me njoftim të prodhuesit, si masë paraprake është vendosur tërheqja e produkteve 'Kinder', ka njoftuar AUV. Kjo agjenci thotë se prodhuesi, në bashkëpunim me distributorin, kanë vendosur t'i tërheqin vullnetarisht këto produkte.



## Hoti akuzon ministrin Murati: Po merr kredi për ndihma sociale

**PRISHTINË, 6 PRILL** - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka miratuar tri marrëveshje ndërkombëtare. Dy prej tyre kanë të bëjnë me marrjen e një kredie për projektin e zhvillimit të impiantit të ujërave të zeza në rajonin e Mitrovicës në vlerë mbi 30 milionë euro, e treta marrëveshja për reformimin e

ndihmës sociale, e cila u rikthye për miratim pasi u rrëzua muaj më parë në Kuvend. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se kjo kredi 47 milionëshe ka për qëllim reformimin e skemave sociale. Mirëpo sërish kritik ndaj kësaj kredie u shpreh deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti.



"Marrëveshja është e njëjtë, nuk do të rritet asistenca sociale, ne nuk kemi hyrë në kredi asnjëherë për ndihma sociale. Çfarë ministri i Financave je kur kërkon kredi për ndihma sociale", ka thënë Hoti. Ndërsa deputeti i PDK-së, Ferat Shala, ka kërkuar nga ministri që kreditë e buta mos të ridestinohen

në projekte të tjera. Siç ka thënë ai, ka ndodhur në Qeverinë Kurti I, kur kreditë e buta janë ridestinuuar për shkollimin e personave të caktuar dhe asambletë kulturore në Dubai. Krahas këtyre, komisioni miratoi edhe plotësimin ndryshimet në Projektligjin për Themelimin e Fondit për Garanci Kreditore.

## Ministri Peci viziton prodhuesit e Kosovës në panairin "Fruit Logistica" në Berlin

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 6 PRILL** - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, i shoqëruar nga ministri i Ministrisë Federale Gjermane të Ushqimit dhe Bujqësisë, Cem Ozdemir dhe ministri i Punëve të Jashtme të Italisë, Luigi Di Maio, ka vizituar panairin "Fruit Logistica" i cili po mbahet në Berlin të Gjermanisë. Gjatë kësaj vizite ministri Peci pati rastin të zhvillojë një bashkëbisedim me të dy ministrat rreth potencialit që kanë shtetet e tyre dhe mundësitë e bashkëpunimit të mëtutjeshëm në sektorin e bujqësisë.

Në "Fruit Logistica" produktet e tyre janë duke i promovuar edhe prodhues nga Republika e Kosovës, të cilët gjatë vizitës ministri Peci i përgëzoi për përfaqësimin mjaft dinjitoz të Kosovës përmes sjelljes së prodhimeve cilësore para konsumatorit evropian. Me këtë rast, Peci u premtoi prodhuesve kosovarë që politikat institucionale do të jenë gjithmonë në të mirë dhe në zhvillim të sektorit të bujqësisë. Panairi "Fruit Logistica" është arena më e rëndësishme e biznesit dhe komunikimit në tregtinë ndërkombëtare të produkteve të freskëta dhe çdo vit ky panair mirëpret rreth 85 shtete pjesëmarrëse.

Gjatë këtij panairi bizneset kanë mundësi të krijojnë lidhje të reja me potencial për zhvillim të agrobizneseve brenda tregut ndërkombëtar të prodhimeve të freskëta.



## Haradinaj fton prokurorinë ta hetojë fryrjen e faturave të energjisë



**PRISHTINË, 6 PRILL (ER)** - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka ftuar prokurorinë ta hetojë fryrjen e faturave të energjisë elektrike. "Kryeministër, kriza energetike


në Kosovë nuk zgjidhet me punësimin enorm të militantëve partiakë e as të atyre që, sipas teje, janë për dasma dhe kanagjegje. A je i vetëdijshëm se faturat e energjisë pas shtrenjtimit në

shumë raste e tejkalojnë dyfishin, e ka dyshime serioze se ato janë fryrë përtej çdo tarife, kategorie apo kriteri. Sot kur është e qartë se qytetarët kanë mbetur krejtësisht vetëm, ftoj organet e hetuesisë që, krahas

hetimeve për punësime abuzive në KEK, t'i fillojnë hetimet edhe për faturat e fundit të energjisë. Ka dyshime serioze që qytetarët janë vjedhur", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".



# Nga Baudelaire te Migjeni



## Nga: Moikom ZEQO

Dy imazhe gati të njehsueshme, pra deri diku dhe paralele. Charles Baudelaire dhe Migjeni. I pari tek proza poetike “Loloja dhe Venera”:

“Parku i gjerë shtrihet si i zalisur përpara syrit përvëlues të Diellit... mua më zënë sytë një qenie të pikëlluar.

Rrëzë një statujë të një Venere kolosale, një nga ato lolot e rremë, një nga ata bufonët që e kanë për detyrë t’i bëjnë të qeshin mbretërit, kur u qepen keq Brerja në ndërgjegje, apo Mërzia, i pispillosur me ngjyra të ndezura, por edhe qesharak, që ka mbi kokë një kapele me brirë dhe me zilka, i mbledhur kruspull para pedestalit, i ngre sytë e mbushur drejt Hyjneshës së pavdekshme të Dashurisë dhe të Bukurisë.

Sytë e Lolos thonë:

–Jam qenia njerëzore më e fundit dhe më e vetmuar, e mbetur pa dashuri, pa miqësi, madje qëndroj më poshtë sesa kafsha më e pazhvilluar. Megjithatë edhe unë jam krijuar për të kuptuar dhe për ta ndjerë Bukurinë e pavdekshme!

Ah, Hyjneshë, vere dorën në zemër për trishtimin dhe për ankthin tim!

Por zemërgurta Venerë, indiferente, me sytë e saj prej

mermeri sdëgjon asgjë dhe nuk dihet se çfarë shikon në largësi.”

Kjo prozë u botua në 1857.

Më 1934 Migjeni boton prozën shumë të çuditshme “Novelë mbi krizën”.

Përfytyron një vend pa koordinata gjeografike dhe kohore. E quan “Shteti X”. Ka trazira të llahtarshme midis të pasurve dhe të varfërve. Të papajtueshme!

Ah, Marks! Por revolucioni mund të klonohet! Po si?

“Përpjekjet e shumta, me rryma të ndryshme, të kundërta, të bazueme në Ungjill, në humanitet, në instinkt, në violencë a në ndoj utopi tjetër nuk mund të bijshin aq shpejt në godi. Shkenca me karakter ekonomik, teknika, mekanika nuk u qayrshin me sy të mirë në mbledhjet e Shtetit X, – arësyeja ishte se ato qenë një shkak i fortë i krizës së tashme, e cila, tashti, si një polip po thith e po shterr trutë e Parisë.

Poshtë e përpjetë, djathtas e majtas, në fund të fundit ra vendimi. U gjet një kompromis. O kompromis, fëmi bastard i të gjitha mbledhjeve! Të dalme dredhurake!

Vendimi i Parisë së Shtetit X ishte ky: me anë të artit të çdollojshëm të nënshtypen ndjenjat e të gjithë nënshtetasvet të Shtetit X, si të varfërvet ashtu dhe të pasurve...

Për një kohë të shkurt shndrojnë faqen Shteti X. Arti i frymëzues dhe i punuam pas recetave të Parisë, shndrojnë Shtetin X në një muzeum artistik. Ishte triumfi i recetës! Ose triumfi i artit me qëllim! E qëllimi u mrrinte dalngadalë por me siguri.

Kurse shndroi faqen Shteti X zunë të shndrojnë trajtat dhe shpirti i nënshtetasve. Shpirti, dikur pëllumb, ishte bam skyfter, tash u ba prap pëllumb.

Sidomos shumë kish bamë për çashtjen, skulptura. Veprat, që paraftojnë të gjitha dashuninat e botës, u gjindshin në çdo skaj, ku përparandej u mbledheshin lypsat për t’organizue shoqata vjedhcash dhe terrori. Ç’e ndryshim ideal!

Tash lypsat, të zbemë nga úja, me supa të mprehtë e kërcikë të ndytë përjashta, rrijnë në podium të monumentavet, dhe rrijnë pa bamë kurrfarë lëvizje kundërshtimi.

Aty rrijnë gjith’ ditën; kur vjen nata, futen nëpër zgavrrat e monumentavet dhe androjnë begatinë shpirtnore. E kur zbardh mëngjesi, një nga një – porsì Charl-Shaplini tragjiko-komik – çohen nga gjini i monumentavet, hapin gojën, shtrijnë duert’ e kambët, dhe ulen në podium për ta çue gjith’ ditën në enerci (inerçi) të plogët.

As nuk hajjnë, as nuk pijnë –

ushqimi i tyre asht bukuria e monumentavet.”

Teksti i Baudelaire-it është një ftillesë. Statuja e Venerës dhe një Lolo përballë. Migjeni e ka lexuar. Padyshim. Kuptohet.

Migjeni imagjionon një utopi negative: Shtetin X. Përpara Zamjatinit, Orwell-it dhe Huxley-it. Një projekt si anti-projekt.

Paria e Shtetit X janë paradhoma për Qenien Supreme të Zamjatinit, të quajtur Benefektori, për Big Brother-in oruellian, apo për konvejerët fordistë të Huxley-it.

Lufta marksiste e klasave, dhuna (revolucioni), doktrinën ungjillore (teologjizmi shterp universal), loja e instinkteve (Frojdi) metaforizohen me ironi, si utopi.

Ah Utopitë e Mëdha! Ah ideologjitë e çmendura!

Nietzsche e mohoi Krishterimin për ta zëvendësuar me Estetikën shpëtimtare për njerëzimin. Kjo tezë e Nietzsche-s e entuziazmoi Migjenin, por në formën sëprapthi. Si kundërshtim perspektiv. Kjo zanafilloi Shtetin X.

Migjeni parandjeu artin doktrinar, ose doktrinën e artit totalitar. Kjo i çon në zgrip tmerrin dhe makthin! Ja çfarë zbuluesi faustian është Migjeni! Loloja i Baudelaire-it i përgjërohet statujës së hyjneshës Venera (ideja se Bukuria dhe

Dashuria e shpëtojnë botën) por Venera është boshësia e simbolit. Migjeni e shfrytëzon këtë ikonografi. Ai shkruan:

“Derisa një ditë, në podium të një monumenti që paraftojnë gruan me shtatzënë, një laps dhe një lypse lindin një djalë (Ma vonë legjenda theshte se u lind nga monumenti me shtatzanë).


Ky djalë është imazhi migjenian që shkatërron imazhin e Lolos së Baudelarie-it. Ai nuk lutet. Nuk përgjërohet. Ai u rrit nga urrejtja. Një mëngjes ky ikonoklast i shkatërroi tëra monumentet, artin e rremë muzeor të Shtetit X Pra, vetë Shtetin X.

Pakufishmëria e këtij akti mendor (e ç’është revolucioni i dhunshëm?) nuk matet dot. Hitlerizmi i pllakatave. Zhdanovizmi i letërsisë. Analiza e Hanah Arendit për totalitarizmin. Shtetet totalitare qenë realë.

Shteti X migjenian dukej (ngjante) si hipotetik, (por jo si republika platoniane e kuajve të Jonotat Swiftit.)

Në Shtetin X nënshtetasit eksperimentalë (oh, ç’kavie laborator!) “as nuk hajjnë, as nuk pijnë – ushqim’ i tyre asht bukuria e monumentavet”

Deliri i Mallarme-së. Kulla e Fildishtë Utopia e Politikës si Utopia e Artit. Teksti i Migjenit është kaq i shkurtër. Njëkohësisht kaq i pafund!



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

## Ademi edhe një mandat në krye të FFK-së

Federata e Futbollit e Kosovës do të udhëhiqet edhe për katër vjet nga Agim Ademi, i cili ishte i vetëm në garë, pasi Gramoz Vokri u eliminua për shkak të disa nënshkrimeve të delegatëve të cilat ishin shpallur të pavlefshme. Në Kuvendin e FFK-së nuk u lejua pjesëmarrja medieve

### “Epoka e re”

**PRISHTINË, 6 PRILL** - Agim Ademi është rizgjedhur kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës edhe për një mandat të ri katërvjeçar. Ademi ishte kandidati i vetëm dhe mori 42 vota nga delegatët, kurse një absteno. Pas rizgjedhjes në krye të FFK-së, Ademi ka premtuar se do të punojë së bashku me delegatët e Kuvendit të FFK-së për ta dërguar përpara futbollin e Kosovës. Ai ka thënë se mandatin e ri nuk e merr si privilegj, por si obligim të madh. “Faleminderit për besimin e dhënë! Këtë mandat të ri nuk e marrë si privilegj, por si obligim të madh. E këtë obligim nuk mund ta kryej pa ju, prandaj ju dua afër vetes. Këtë përgjegjësi dhe ndihmë që ma jepni unë e marr me shumë seriozitet edhe për ata që kanë

mendime ndryshe. Besimin do t’jua kthej të gjithëve me punën time, pasi jam njeri i futbollit dhe jam i lumtur që jam në familjen time apo mos të them në zanatin tim. Kur them në zanatin tim, them pasi jam një jetë në futboll si futbollist, kryetar klubi dhe prijës i federatës. I di hallet e futbollistit, klubit dhe punët e federatës. Di të jem punëtor dhe i mirë me organizatat. Unë jam vullnetar në futboll dhe do të vazhdoj të jem i tillë”, ka thënë Ademi.

Në Kuvendin e FFK-së u shqyrtua dhe u miratua raporti financiar dhe i auditimit për vitin 2021 dhe plani financiar për vitin 2022, si dhe u autorizua Zyra Ligjore e FFK-së për fillimin e ndryshimit të Statutit të FFK-së konform kërkesave të UEFA-s dhe të FIFA-s. Në punimet e Kuvendit morën pjesë anëtarë të KE të UEFA-s, njëherësh presidenti i

FShF-së, Armand Duka, përfaqësuesit e FIFA-s, Alessandro Gramaglia dhe Sofia Malizia, përfaqësuesi i UEFA-s, Denis Bastari, presidenti i Federatës së Futbollit të Maqedonisë së Veriut, Muhamed Sejdiu, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Sportit. Mirëpo pjesëmarrjen në këtë kuvend e kishin të ndaluar mediet, me arsyetimin se nuk ka hapësirë të mjaftueshme.

**Opozita e FFK-së: Nëse nuk merren masa ndaj Kuvendit të jashtëligjshëm, mund t’i bojkotojmë garat**

Ndërsa klubet që janë opozitë e FFK-së nuk kanë marrë pjesë në Kuvendin Zgjedhor. 15 delegatë janë mbledhur dhe e kanë shprehur opinionin e tyre të përbashkët rreth këtij Kuvendi, të cilin e kanë bojkotuar pasi e konsiderojnë atë të parregullt dhe të jashtëligjshëm. “Sot është dashur të jetë një ditë feste, por nuk ju kanë lejuar as ju medieve të hyni aty. Andaj, më e keqja është cenimi i lirisë së shprehjes edhe me votë. Ne si grup që mendojmë ndryshe jemi grup që nuk e



mbështesim këtë Kuvend sepse opinioni ligjor ka thënë se është i paligjshëm. Në shenjë të respektit të ligjeve të sportit, s’kemi marrë pjesë në atë Kuvend”, ka thënë Valon Zymberi. “Ne na është mohuar e drejta elementare e kandidatit të kandidatit tonë Gramoz Vokri. FFK-ja ka treguar mendësi totalitare. Ne jemi po ata delegatë që e kemi mbështetur Vokrin dhe jemi këtu e nuk jemi në atë Kuvend. Do të jemi deri në fund në mbështetje të Gramozit dhe nuk e mbështesim një Kuvend

të paligjshëm. Kemi dashur të jemi vetëm delegatët që kemi dhënë publikisht nënshkrime për Vokrin. Nuk e di a ka ai Kuvend kuorum dhe i ftoj organet ta monitorojnë me kujdes sepse po e mbajnë një Kuvend të jashtëligjshëm”, ka shtuar Zymberi. “Kandidati ynë ka qenë legjitim. Ja ku mund ta shihni listën me nënshkrime. Duhet të intervenojë MKRS-ja dhe organet përgjegjëse. Në të kundërtën, nëse nuk merren masa nga institucionet, mbetet opsioni bojkotimi i garave”, ka deklaruar Zymberi.

## Kolegji AAB, marrëveshje bashkëpunimi me FGJK-në

**PRISHTINË, 6 PRILL** - Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit i Kolegjit AAB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Gjymnastikës së Kosovës. Bashkëpunimet e ndërsjella me institucione relevante dallojnë Kolegjin AAB për mundësitë e punës karshi studentëve. Së fundi, Kolegji AAB, gjegjësisht Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Federatën e Gjymnastikës së Kosovës duke u bazuar në përcaktimin e programeve të përbashkëta për realizimin e pjesës praktike të studentëve, për mbrojtjen e interesit të studentëve, për zhvillimin e njohurive të reja, respektivisht atyre praktike, në kuadër të lëndës së



gjymnastikës. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, prof. asoc. dr. Fatmir Pireva, dhe nënkryetares së Federatës së Gjymnastikës, Abelianë Bregu. Ndër të tjera, në sajë të këtij bashkëpunimi

do të bëhen edhe organizime të konferencave shkencore dhe shkëmbimi i përvojave me synim të fuqizimit të politikave edukative - arsimore, emancipimin dhe afirmimin e vlerave të mirëfillta të studentëve.

## Sot zhvillohen gjysmëfinalet e Kupës

**PRISHTINË, 6 PRILL** - Sot (e enjte) do të zhvillohen dy ndeshjet e para gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në futboll. Prishtina dhe Llapi do të përballen në mes vete në kryeqytet në duelin kryesor të kësaj faze, kurse ballafaqimi tjetër është ai në mes të Dritës me Ramiz Sadikut. Gjilanasit shihen si favoritë për të kaluar në finale, edhe pse duhet të priten dy përballjet pasi, siç dihet, në këtë fazë luhet me sistem vajtje/ardhje. Fituesi i Kupës e siguron daljen në Evropë dhe për këtë arsye kjo garë është bërë edhe më interesante dhe më joshëse vitet e fundit. Fitues aktual i Kupës së Kosovës është Llapi.



**KUPA E KOSOVËS**

Të enjten takohen:  
14:00 Prishtina - Llapi  
14:00 Drita - Ramiz Sadiku

## Marku: Po diskutojmë që ndeshja e radhës të zhvillohet në Shqipëri

**TIRANË, 6 PRILL** - Boksieri shqiptar Florian Marku ka bërë me dije se është duke diskutuar që ndeshjen e ardhshme ta zhvillojë në Shqipëri. Marku,

përmes një postimi në “Facebook”, ka shkruar që mezi pret të zhvillojë një ndeshje në Shqipëri. “Mezi po pres të rikthehem për një ndeshje në

Shqipëri dhe ta shoh atmosferën plot me flamuj kuq e zi. Jemi në diskutime që ndeshja e radhës të jetë në Shqipëri”, ka shkruar Marku.

Ditë më parë Marku arriti ta mbrojë titullin në IBF ndaj britanikut Jenkins, përballje e cila ishte zhvilluar në Newcastle.



## Woods rikthehet në fushë: Optimist se mund të fitoj sërish një Masters

Uashington, 6 prill - Golfisti amerikan Tiger Woods ka bërë me dije se do të rikthehet të luajë këtë vit në një turne Masters. Ai nuk luan në një ngjarje të madhe që prej nëntorit 2020, kur mori pjesë në turneun e Augusta National. Më

pas ai u aksidentua në shkurtin e vitit të kaluar dhe tashmë është gati të rikthehet në fushë. Ikona e këtij sporti, që tashmë ndodhet në vendin e 944 të renditjes botërore, synon të bëjë një rikthim të bujshëm në fushat e gjelbra të golfit.

Aksidenti dhe dëmtimet e shpeshta kanë lënë gjurmë te Woodsi, por fituesi i 15 ngjarjeve të mëdha në gold shprehet se do të bëjë më të mirën e mundshme. "Ndiem gati për të luajtur sërish. Kam nisur të stërvitem dhe luaj çdo ditë e më

shumë. Rikuperimi nga aksidenti dhe operacioni kanë shkuar mirë. Ndiem shumë entuziast për të ardhmen. Nuk e di se deri ku mund të shkoj, por jam optimist se mund të fitoj sërish një turne të madh", u shpreh Tiger Woods.



## Pesë shqiptarë mund ta përfaqësojnë Zvicrën në Botëror

CYRIH, 6 PRILL - Kombëtarja zvicerane e siguroi kualifikimin në Kampionat Botëror duke shfaqur siguri në fazën e grupeve. Pa dyshim kontribut në këto rezultate kishin edhe futbollistët shqiptarë. Dy yjet e padiskutueshme të "helvetikëve" janë Xherdan Shaqiri dhe Granit Xhaka. Falë tyre zviceranët në dekadën e fundit i kanë arritur sukseset më të mëdha në histori. Krahas dy të pakontestuarve Shaqiri e Xhaka, në Kampionat Botëror fanellën e Zvicrës mund ta veshë edhe futbollisti tjetër i këtij reparti, Kastriot Imeri, i cili luan në Servette. Sipas portalit "rts.ch", mesfushori kosovar është një prej kandidatëve potencialë, por që ftesa e tij varet nga zgjedhja e klubit, forma fizike dhe arsye të



tjera. E në sulm mund të ftohen dy futbollistë të tjerë, Andi Zeqiri, i cili luan në Augsburg dhe Alban Ajeti, që është pjesë e Celticut. Zeqiri madje u ftua dhe luajti në ndeshje me Kosovën në muajin mars. Mbetet të shihet se

cilët prej këtyre futbollistëve kosovarë do ta përfaqësojnë Zvicrën në evenimentin më të rëndësishëm të futbollit botëror, i cili do të fillojë në nëntor dhe do të mbyllet në dhjetor të këtij viti.

### SHKURT

#### Guardiola: Atletico luajti me formacion 5-5-0

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, e ka sulmuar Atletico Madridin për mënyrën e lojës që e aplikoi të martën mbrëma në "Etihad Stadium". "E kishim paramenduar që ata do të luanin me skemën 5-3-2, por më pas ata kaluan në skemën 5-5-0. Në kohët parahistorike, sot dhe njëqind mijë vjet më pas, është shumë e vështirë të sulmosh një sistem të tillë loje. Nuk ka hapësira, janë fizikisht të fortë, ne jemi të vegjël dhe të lehtë. Duhet të bësh durim. E ndiej që do të jetë një ndeshje e ngjashme edhe në Madrid", ka deklaruar Guardiola.

#### Klopp: Kualifikimin e kompletojmë në 'Anfield'

Liverpooli konfirmoi edhe një herë statusin e favoritit në Ligën e Kampionëve, pasi e mposhti Benficën me rezultatin 3-1, një sukses që e lejon të prekë me një rëndësi dorë fazën gjysmëfinale. "Benfica kishte një strategji të qartë, bëri presion lart dhe nuk ishte e thjeshtë për ne të gjenim hapësira. Duhet të ishim të qetë dhe të kishim thellësi në sulm. Në disa çaste gjatë ndeshjes na vendosën në vështirësi, mund dhe të kishim shënuar më shumë, por portieri i tyre ishte lojtari i ndeshjes. Tani e njohim më mirë rivalin tonë. Jemi në gjysmë të rrugës dhe besojmë se këtë do ta kompletojmë në shtëpinë tonë", ka thënë Klopp.

#### Van Gaal largohet nga Holanda, rikthehet Koeman

Luis Van Gaal nuk do të jetë më trajner i Holandës pas Botërorit "Katar 2022". Këtë lajm e ka bërë me dije vetë kombëtarja "portokalli" me anë të një komunikate zyrtare ku ndan rrugët me teknikun 70-vjeçar për të afruar më 1 janar 2023 ish-trajnerin e Barcelonës, Ronald Koeman. Van Gaal drejtoi Holandën për 9 ndeshje, ku ka arritur të koleksionojë 6 fitore, 3 barazime dhe asnjë humbje. Ndërsa Kuman do të bashkohet sërish me kombëtaren holandeze pas gati një vit e gjysmë.

#### Napoli sfidon Juven në garë për Zaniolon

Skuadra e Napolit është serioze në garë për Nicolo Zaniolo. Vlerësimi fillestar i Romës, i cili është 50 milionë euro, nuk i tremb azurrët, të cilët duken se e kanë shumë seriozisht transferimin e tij. Sipas "Corriere dello Sport", ai është profili i identifikuar nga drejtuesit për ta plotësuar vendin që do të lërë Insigne, i cili do të largohet në fund të sezonit në drejtim të Torontos. De Laurentis dëshiron që t'i bëjë këtë dhuratë Spallettit për sezonin e ardhshëm. Në garë për yllin italian është edhe skuadra e Juventusit.

## Lakersat zyrtarisht jashtë 'play off'-it

PHOENIX, 6 PRILL - Sezoni i lakersave mund të konsiderohet i përfunduar. Ekipi kalifornian, që e niste këtë sezon si favorit, tashmë është matematikisht jashtë zonës "play-off". Lakersat u mposhtën me rezultat 121-110 nga Phoenixi (humbja e shtatë radhazi), skuadra më e mirë në Perëndim. Westbrook me 28 pikë e Davisi me 21 u përpoqën t'i mbajnë në lojë kalifornianët, por pa sukses (mungoi James). Booker me 32 pikë ishte më i miri për Sunsib. Fitoi skuadra e



Brooklynit, që e mposhti me rezultat 118-105 Houstonin, ndeshje ku për Netsin u dallua Irvingu me 42 pikë. Pa probleme fitoi edhe Philadelphia, që mposhti me rezultat 131-122 Indianan jashtë fushës. Për miqtë u dalluan Embiid me 45 pikë e 13 rebounde si dhe Maxey me 30 pikë. Pas kohës shtesë triumfoi Utah Jazz, që mundi me shifrat 121-115 Memphisin, ndeshje ku dallimin në parket e bënë Gobert

e Clarkson me nga 22 pikë secili. Skuadra kampione e Milwaukee Bucksit fitoi me rezultat 127-106 në fushën e Chicagos, në një takim të komanduar gjatë gjithë kohës nga miqtë. Shtatë lojtarë të Bucksit realizuan mbi 10 pikë (Lopez me 28 pikë më i miri). Në krye të renditjes në Lindje qëndron ekipi i Miami, që fitoi pa probleme me rezultat 144-115 ndaj Charlottes (Herro 35 pikë e Butleri 27 pikë).

### REZULTATET

Indiana - Philadelphia	122-131
Orlando - Cleveland	120-115
Brooklyn - Houston	118-105
Miami - Charlotte	144-115
Toronto - Atlanta	118-108
Chicago - Milwaukee	106-127
Minnesota - Washington	114-132
Oklahoma - Portland	98-94
Denver - San Antonio	97-116
Utah Jazz - Memphis	121-115
Sacramento - New Orleans	109-123
Phoenix - Lakers	121-110

## Rooney: Skuadrës i duhen lojtarë të uritur, jo si Ronaldo e Pogba

Legjenda e Manchester Unitedit, Wayne Rooney ka shprehur kritika të ashpra ndaj drejtuesve të klubit për situatën ku ndodhet skuadra e "Djajve të Kuq". Duke folur në

"Night Football", në "Sky Sports" ai kërkon rithemelimin e skuadrës, ndërsa cilëson si faktorë të mungesës së rezultateve Paul Pogban dhe Cristiano Ronaldon. Sipas tij,

këta emra nuk kanë motivimin e duhur për ta rritur grupin. "Duhen lojtarë të rinj më të uritur për ta ngritur ekipin në 2-3 vjetet e ardhshëm. Vërtet Ronaldo mbetet një kërcënim

në sulm, por ai nuk është lojtari i njëjtë si në kohën kur ishte 20 vjeç", ka thënë Rooney, i cili ka folur edhe për Pogban: "Ai ka arritur një pikë ku është më mirë për të ecur përpara. Ai

nuk ka pasur ndikimin që do të kishte dashur që kur u kthye në Manchester United. Unë e shikoj atë me Francën dhe ai është një lojtar krejtësisht tjetër aty".



## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Pozita:</b>	Administrator i Sistemeve (zyrtar i lartë)
<b>Departamenti:</b>	Teknologjia Informative
<b>Divizioni:</b>	Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
<b>Grada:</b>	5

### Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Konfiguroni, monitoroni pajisjet në infrastrukturë të DTI, përfshirë serverët, storage, switch dhe pajisjet tjera përcjellëse;
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban sistemet operative në serverë fizik dhe virtual;
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban sistemet me role të caktuara, siç janë: Active Directory, File Server, IIS Server, MS Exchange Server, SQL Server, etj;
- Administron infrastrukturën e PKI, përfshirë menaxhimin e certifikatave;
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban replikimet e të dhënave dhe sistemeve në mes dy qendrave;
- Konfiguroni, instaloni, monitoroni dhe mirëmban backup-ët e të dhënave dhe sistemeve;
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative;
- Menaxhon infrastrukturën, duke përfshirë instalimet dhe shpërndarjen e azhurnimeve dhe ndryshimeve përmes Microsoft Endpoint Manager (ish System Center Configuration Manager);
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme;
- Konfiguroni, instaloni dhe përditëson softuerët në baza të rregullta në serverët dhe kompjuterët e shfrytëzuesve;
- Bashkëpunon ngushtë me Administratorët dhe teknikët brenda Divizionit dhe me zyrtarët e Divizionit të Sigurisë së Informacionit dhe Vazhdimësisë së Punës;
- Trajton dobësitë në infrastrukturë, në aspekt të sigurisë dhe përcjellë log-ët e sigurisë;
- Përcjell dhe aplikon standardet e sigurisë së informacionit;
- Monitoroni dhe mirëmban sistemin e printimit;
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI;
- Mirëmban dokumentimin e konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës;
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative.

### Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkallë bachelor në shkenca kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit, MCSE ose CompTIA Server+ .
- Përvojë së paku 1 vjeçare në administrim të sistemeve dhe sistemeve operative Windows Server 2012 R2, 2016, 2019. Përvojë në sigurinë e sistemeve është e preferueshme;
- Njohuri në menaxhim të DNS, DHCP, PKI;
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar;
- Përvoja ose certifikim në ITIL i preferuar;
- Gjuha angleze - e preferuar.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust-i;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të

njohura / nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;

- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 21 prill 2022.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



## OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Položaj:</b>	Administrator sistema (viši službenik)
<b>Odeljenje:</b>	Informacione tehnologije
<b>Odsek:</b>	Informacione tehnologije i sistema
<b>Izveštava:</b>	upravniku Odseka za informacionu tehnologiju i sisteme
<b>Stepen:</b>	5

### Radne dužnosti i odgovornosti:

- Konfigurise, nadgleda opremu u infrastrukturi OIT, uključujući servere, storage, switch i drugu prateću opremu,
- Konfigurise, instalira, nadgleda i održava operative sisteme na fizičkim i virtuelnim serverima,
- Konfigurise, instalira, nadgleda i održava sisteme sa određenim ulogama, kao što su: Active Directory, File Server, IIS Server, MS Exchange Server, SQL Server, itd.
- Administrira PKI infrastrukturu, uključujući upravljanje sertifikatima,
- Konfigurise, instalira, nadgleda i održava replike podataka i sistema između dva centra.
- Konfigurise, instalira, nadgleda i održava backup-ove podataka i sistema.
- Služi kao drugi nivo suočavanja sa incidentima i problemima kod svih korisnika informacione tehnologije.
- Upravlja infrastrukturom, uključujući instaliranje i raspodelu ažuriranja i promena preko Microsoft Endpoint Manager-a (ranije je bio Sistem Center Configuration Manager)
- Održava licence i komunicira sa spoljnim pružaocima usluga.
- Redovno konfigurise, instalira i ažurira softvere na serverima i računarima korisnika.
- Blisko saraduje sa administratorima i tehničarima u okviru odseka i sa službenicima Odseka za bezbednost informacija i neprekidnosti rada.
- Obrađuje slabosti u infrastrukturi, u smislu bezbednosti i prati logove bezbednosti
- Prati i primenjuje standarde bezbednosti informacija
- Nadgleda i održava sistem štampanja.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranju.
- Održava dokumentaciju konfiguracija, stvara postupke i priručnike za svu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Ostale dužnosti koje se zadaju od nadležnih u hijerarhiji Odeljenja za informacionu tehnologiju.

### Zatražene kvalifikacije i iskustvo:

- Završen bachelor u računarskim naukama ili srodne sertifikacije vezane za ulogu administratora, MCSE ili CompTIA Server+ .
- Najmanje 1. godina iskustva u administraciji sistema i operativnim sistemima Windows Server 2012 R2, 2016, 2019. Poželjno je iskustvo u oblasti bezbednosti sistema.
- Poznavanje u upravljanju DNS, DHCP, PKI.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poželjno iskustvo ili sertifikacija u ITIL.
- Poželjno- engleski jezik.

### Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovaj položaj;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije podržan dokazima iz Trusta;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu;

### Postupak prijavlivanja:

- Krajni rok za prijavu je **21. april 2022.** godine.
- Prijava se može izvršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične stranice interneta CBK-a ili preko arhive CBK-a. Nijedan drugi obrazac za prijavu neće se uzeti u obzir.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti sa zvanične internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Nepotpuna dokumentacija neće se razmatrati. Samo kandidati koji ispunjavaju uslove konkursa biće kontaktirani.**



## SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Pozita:</b>	Analist i Sigurisë së Informacionit (zyrtar i lartë)
<b>Departamenti</b>	Teknologjia Informativë
<b>Divizioni:</b>	Divizioni i Vazhdimësisë së Punës dhe Sigurisë së Informacionit
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Divizionit të Vazhdimësisë së Punës dhe Sigurisë së Informacionit
<b>Grada:</b>	5

### Përgjegjësitë dhe detyrat e punës :

- Konfiguroni sistemet dhe veglat e sigurisë së informacionit, i mirëmban dhe sigurohet që funksionojnë sipas kërkesave, duke përfshirë ato për mbledhje të log-ëve, skanime të sigurisë për dobësi dhe sisteme të tjera të sigurisë së informacionit;
- Monitoroni rrjetin kompjuterik për çështjet e sigurisë së informacionit;
- Monitoroni, analizoni dhe raportoni alarmet e sigurisë së informacionit, incidentet, raportet mbi dobësitë që mbledhen nga disa burime, si: SIEM, sisteme të tjera të monitorimit, skanime të ndjeshmërive, etj.
- Rishikoni, hulumtoni dhe raportoni alarmet e ndjeshmërive, duke ofruar:
  - analizën relevante të tyre,
  - propozon përmirësimet e nevojshme dhe përcjellë përmirësimet e propozuara,
  - menaxhon skanimet e planifikuara, identifikon zbrastëtitë në to dhe zgjeron fushën e skanimeve sipas nevojës, si dhe përshkallëzon alarmet e sigurisë së informacionit sipas nevojës.
- Hulumtoni shkeljet dhe incidentet tjera të sigurisë së informacionit;
- Dokumentoni shkeljet e sigurisë së informacionit dhe vlerësoni dëmin që ato shkaktojnë;
- Punoni me ekipin e sigurisë së informacionit për të kryer teste dhe për të zbuluar dobësitë në rrjet dhe sisteme;
- Rregulloni dobësitë e zbuluara për të ruajtur një standard të lartë të sigurisë;
- Zhvilloni praktikatat më të mira në BQK për sigurinë e informacionit;
- Ndihmoni në përgatitjen dhe implementimin e programit të vetëdijesimit të shfrytëzuesve të BQK-së për praktikatat më të mira të sigurisë së informacionit dhe politikave të DVPSI;
- Mbështetni iniciativat e propozuara të sigurisë së informacionit që të sigurojnë suksesin e tyre;
- Kërkon përmirësime të sigurisë së informacionit dhe jep rekomandime për menaxhmentin;
- Qëndroni i azhurnuar në lidhje me avancimet dhe standardet në fushën e sigurisë së informacionit;
- Kryeni detyra të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit.

### Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

Shkallë universitare (bachelor) nga një institucion i akredituar në Kosovë në fushën e Shkencave Kompjuterike, Sistemeve të Informacionit ose certifikime relevante në fushën e sigurisë së informacionit (p.sh. CISSP, CCNA Security, CompTia Security+) (ata të cilët kanë përfunduar shkollim jashtë vendit duhet të ofrojnë nostrifikimin e diplomës nga MASHT). Së paku një vit përvojë në siguri të informacionit dhe teknologji informative. Gjuha angleze - e preferuar.

### Njohuritë, aftësitë e kërkuara

- Njohuri mbi konceptet e firewalls, proxies, SIEM, antivirus;
- Njohuri në reagime ndaj incidenteve të sigurisë së informacionit;
- Njohuri dhe/ose përvojë në vlerësimin e konfigurimeve të sigurisë për të përmbushur nevojat e organizatës;
- Njohuri në interpretimin e vlerësimeve të cënueshmërisë;
- Njohuri të familjes së standardeve ISO27000 dhe kornizës MITRE ATT&CK;
- Njohuri të sistemeve operative, rrjetave kompjuterike dhe firewalls;
- Njohuri në shqyrtimin dhe analizimin e log-ëve dhe formateve të ndryshme të tyre;
- Aftësi për të identifikuar dhe zbutur dobësitë e rrjetit dhe për të shpjeguar se si të shmangen ato;
- Aftësi për të paraqitur dhe shpjeguar tema komplekse teknike, probleme, zgjidhje alternative për të tjerët;
- Aftësi të shkëlqyera organizative dhe komunikuese (me gojë dhe me shkrim);
- Aftësi të shkëlqyera të menaxhimit të kohës;
- Aftësi të forta ndërpersonale dhe aftësi për të komunikuar në mënyrë efektive në grup.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust-i;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura / nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 21 prill 2022.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit do të kontaktohen.**



## OGLAŠAVANJE SLOBODNOG RADNOG MESTA

<b>Položaj:</b>	Analista bezbednosti informacija (viši službenik)
<b>Odeljenje:</b>	Informacione tehnologije
<b>Odsek:</b>	Odsek za neprekidnost rada i bezbednost informacija
<b>Izveštava:</b>	upravniku Odseka za neprekidnost rada i bezbednost informacija
<b>Stepen:</b>	5

### Radne dužnosti i odgovornosti:

- Konfigurise, održava i obezbeđuje funkcionisanje sistema i alata za bezbednost informacija prema zahtevima, uključujući i one za prikupljanje logova, skeniranje bezbednosti radi ranjivosti i ostale sisteme bezbednosti informacija.
- Nadgleda računarsku mrežu u vezi pitanja bezbednosti informacija.
- Nadgleda, analizira i izveštava o uzbunama bezbednosti informacija, incidentima, izveštajima o ranjivosti prikupljenim iz nekoliko izvora, kao što su: SIEM, ostali sistemi praćenja, skeniranje osetljivosti itd.
- Pregleda, istražuje i izveštava o uzbunama osetljivosti, davanjem:
  - njihove relevantne analize,
  - predlaže potrebna poboljšanja i prosleđuje predložena poboljšanja,
  - upravlja planiranim skeniranjima, identifikuje nedostatke u njima i po potrebi proširuje obim skeniranja kao i postepeno daje uzbune bezbednosti informacija prema potrebi.
- Istražuje kršenja i druge incidente u smislu bezbednosti informacija.
- Dokumentuje kršenja bezbednosti informacija i procenjuje štetu koju one uzrokuju.
- Radi sa timom za bezbednost informacija na izvođenju testiranja i otkrivanju ranjivosti u mrežama i sistemima.
- Rešava otkrivene ranjivosti radi održavanja visokog standarda bezbednosti.
- Razvija najbolje prakse u CBK-u za bezbednost informacija.
- Pomaže u pripremi i sprovođenju programa za podizanje svesti CBK-ovih korisnika o najboljim praksama bezbednosti informacija i politikama ONRBI-a.
- Podržava predložene inicijative za bezbednost informacija kako bi se osigurao njihov uspeh.
- Traži poboljšanja u bezbednosti informacija i daje preporuke upravi.
- Prati napredak i standarde u oblasti bezbednosti informacija.
- Obavlja i druge poslove po zahtevu upravnika.

### Zatražene kvalifikacije i iskustvo:

Univerzitetska diploma (bachelor) iz institucije akreditovane na Kosovu u oblasti računarskih nauka, informacionih sistema ili odgovarajućih sertifikata u oblasti bezbednosti informacija (npr. CISSP, CCNA Security, CompTia Security+) (oni koji su završili obrazovanje u inostranstvu moraju obezbediti nostrifikaciju diplome od strane MONT-a). Najmanje jedna godina iskustva u oblasti informacione bezbednosti i informacione tehnologije. Engleski jezik - poželjno.

### Potrebna znanja i veštine

- Znanje o konceptima firewalls, proksija, SIEM-a, antivirusa.
- Zna kako da reaguje u slučaju incidenta bezbednosti informacija.
- Zna i/ili ima iskustvo u proceni konfiguracija bezbednosti za ispunjavanje potreba organizacije.
- Zna tumačenje procena ranjivosti.
- Zna porodice standarda ISO27000 i okvira MITRE ATT&CK
- Zna operative sisteme, računarske mreže i firewalls.
- Zna da razmatra i analizira logove i njihovih različitih formata.
- Ima sposobnost identifikovanja i ublažavanja ranjivosti mreže i objašnjenja kako ih izbeći.
- Ima sposobnost prikazivanja i objašnjenja složenih tehničkih tema, problema, alternativnih rešenja drugima.
- Odlučne organizacione i komunikacione (usmene i pismene) veštine.
- Odlučne veštine upravljanja vremenom.
- Jake međuljudske veštine i sposobnost efikasne komunikacije u grupi.

### Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se navodi interesovanje za ovaj položaj;
- Dokaz o radnom iskustvu izdat od nadležne institucije/organizacije podržan dokazima iz Trusta;
